VENDIM
Nr.42, datë 26.10.2005

MBI ANALIZËN E GJENDJES FINANCIARE TË SHOQËRISË SË SIGURIMEVE "INTERALBANIAN" SHA PËR 6- MUJORIN E PARË TË VITIT 2005

Në mbështetje të shkronjave "d", "k" të pikës 2 të nenit 14 të ligjit nr.9268, datë 29.7.2004 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës së Sigurimeve" dhe të neneve 107 dhe 175 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 " Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", pasi shqyrtoi materialet e përgatitura nga organi ekzekutiv, Këshilli i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve

VENDOSI:

1. Ti kërkojë shoqërisë së sigurimit INTERALBANIAN sh.a. të autorizuar nga Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve për ushtrim aktiviteti në sigurime me nr.9, datë 19.7.2004 dhe me leje të ushtrimit të aktivitetit në sigurime nr. 9/1, datë 10.9.2004, që brenda një periudhe jo më shumë se dy muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi për mbulimin e përgjegjësive që rezultojnë mbi mundësitë e saj siç parashikohen nga neni 107 i ligjit të sipërpërmendur:

a) Të marrë masa për risigurimin, rritjen e kapitalit themeltar në nivelin e kërkuar dhe të depozitojë në llogarinë qëllimore fondin e kërkuar të garancisë.

b) Në rast të mospërmbushjes së kërkesave të pikës l/a, shoqëria të zgjidhë kontratat e përgjegjësive të marra, që janë në tejkalim të kërkesave të nenit 107 të ligjit të sipërpërmendur.

2. Të zhbllokojë pjesën e fondit të garancisë së bllokuar si kolateral për efekt kredie.

3. Të marrë masa për uljen e shpenzimeve operative, në masën e parashikuar sipas plan-biznesit, mbi bazën e të cilit është licencuar si shoqëri sigurimi.

4. Të marrë masa për uljen e gjendjes së *cash* në arkë, deri në nivelin 3% të provigjoneve teknike, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

5. Të anulojë kontratën e mbulimit me shoqërinë e sigurimit Intersig për sigurimin e pasurisë së Agjencisë Nacionale të Trafikut Ajror SHA, pasi në gjendjen aktuale kjo kontratë nuk konsiderohet bashkësigurim.

6. Deri në momentin e ngurtësimit të fondit të garancisë sipas kërkesave të pikës 2/a të nenit 98 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004, shoqëria ndalohet të lidhë kontrata të reja të sigurimit që i përkasin klasave 10, 11, 12, 13, 15 sipas klasifikimit të parashikuar në nenin 7 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004.

7. Deri në momentin e ngurtësimit të fondit të garancisë sipas kërkesave të pikës 2/b të nenit 98 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004, Shoqëria ndalohet të lidhë kontrata të reja sigurimi që i përkasin klasave 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 sipas klasifikimit të parashikuar në nenin 7 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004.

8. Ngarkohet shoqëria INTERALBANIAN sh.a. dhe Ekzekutivi i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datë 26.10.2005.

KRYETARE E KËSHILLIT
TË AUTORITETIT MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE
Burbuqe Riba